



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA  
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 207 prot.

Tiranë, më 18/01 .2022

**RAPORT I ECURISË TË PUNËS NË SEKTORIN E FINANCËS PËR  
VITIN 2021**

Drejtuar: **Znj. Ledia Tota**  
**Drejtor i Përgjithshëm**

Nëpërmjet: **Enida Malaj**  
**Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse**

Përgatiti: **Sonjela Borova**  
**Përgjegjës i Sektorit të Financës, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve  
Mbështetëse**

Në zbatim të udhëzimit Nr.4 datë 25.01.2021, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021", Agjencia e Zhvillimit të Territorit është kategorizuar te programi 01150 "Shërbime të tjera", grupi 87. Plani vjetor i buxhetit i akorduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për institucionin dhe realizimi për vitin 2021 sipas llogarive përkatëse është si më poshtë:

	Buxheti I akorduar per vitin 2021	Buxheti 2021 me ndryshime	REALIZIMI	FONDE TE LIRA DHJETOR 2021	realizimi ne %
600	39,000,000	38,000,000	37,776,224	223,776	99%
601	4,400,000	6,450,000	6,293,727	156,273	98%
602	35,687,000	34,637,000	34,629,527	7,473	100%
606	100,000	100,000	90,900	9,100	91%
231	1,000,000	1,000,000	946,680	53,320	95%
<b>Total</b>	<b>80,187,000</b>	<b>80,187,000</b>	<b>79,737,058</b>	<b>449,942</b>	<b>99%</b>

Për shpenzimet korrente ku përfshihen artikujt 600 , 601 dhe 602 realizimi është kryer përkatësisht në masën 99 % , 98 % dhe 100 % . Investimet janë realizuar në masën 95%.

Sektori i Financës për vitin 2021, krahas realizimit të planit vjetor të buxhetit 2021 ka realizuar objektivat si më poshtë:

1. Ka ndjekur dhe zbatuar urdhërat dhe shkresat e dërguara për Sektorin e Financës sipas udhëzimeve ligjore përkatëse dhe afateve kohore.
2. Ka detajuar planin e buxhetit për vitin 2021 sipas llogarive 600,601,602 dhe 231 sipas nevojave të institucionit për gjithë vitin kalendarik 2021.
3. Ka përgatitur në sistemin HRMIS dhe kaluar listëpagesat e punonjësve në Degën e Thesarit Tiranë dhe në BKT Bank çdo fillim muaji.
4. Ka përgatitur, dërguar dhe rakorduar evidencat mujore në Degën e Thesarit Tiranë brenda datës 5 të çdo muaji pasardhës duke ju referuar limiteve mujore të llogarive përkatëse.
5. Ka përgatitur listëpagesat e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, likuidimin e tyre në Degën e Thesarit Tiranë, gjithashtu dhe deklarimin online çdo muaj në [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al) brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj.
6. Ka përgatitur pasqyrat financiare të vitit 2020 sipas udhëzimit Nr.46, datë 24.12.2020, “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020”, dhe ka paraqitur ato në Degën e Thesarit Tiranë, Kryeministri, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Instat.
7. Ka përgatitur dhe dërguar evidencat katërmujore dhe vjetore të Azht-së, për Instat-in, për vitin 2021, duke iu referuar afateve kohore të udhëzimit Nr.4 datë 25.01.2021, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”.
8. Ka përgatitur dhe dërguar Pyetësin e Vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
9. Ka plotësuar Librezat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve, për vitin 2021.
10. Ka përgatitur Ditarin e Urdhër Shpenzimeve, Ditarit të Thesarit, Evidencën, Hyrjet dhe Daljet e magazinës. Është bërë furnizimi i punonjësve me materiale sipas kërkesave dhe nevojave për mirë funksionimin e punës. Janë plotësuar kartelat inventarizuese për çdo punonjës sipas levizjeve të bëra gjatë vitit nëpërmjet fletë hyrjeve dhe fletë daljeve nga magazina.
11. Ka përgatitur dhe dërguar regjistrin e parashikimit të prokurimit publik sipas nevojave të institucionit në Degën e Thesarit Tiranë në bashkëpunim me sektorin juridik.
12. Ka përgatitur dhe dërguar Raportin e Monitorimit të Azht-së, katërmujor dhe vjetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë duke ju referuar afateve kohore të përcaktuara në udhëzimit Nr.4 datë 25.01.2021, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”.
13. Ka bërë deklarimin online në sistem, të tatimit në burim çdo muaj për Azht-në, në [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al) brenda datës 20 të çdo muaji pasardhës.
14. Ka përgatitur regjistrin e riskut për të gjitha drejtoritë e Azht-së duke ju referuar Ligjit Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me ligjin 110/2015 datë 15.10.2015.
15. Ka përgatitur Urdhërin për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik.
16. Ka përgatitur Deklaratën dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë për vitin 2020

17. Ka përgatitur Hartën e Proceseve dhe Gjurmës së Auditit për Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

18. Ka bërë raportimin e detyrimeve të prapambetura të institucionit për vitin 2021. në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, duke ju referuar afateve kohore të udhëzimit Nr.4 datë 25.01.2021, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”.

19. Ka përgatitur urdhër shpenzimet dhe ndjekur realizimin e tyre deri në përfundim në Degën e Thesarit Tiranë, duke ju referuar me përpikmëri klasifikimit buxhetor ekonomik për llogaritë përkatëse.

20. Ka përgatitur Librin e pagave për vitin 2021.

21. Ka përgatitur dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, programin buxhetor afatmesëm për vitet 2022-2024 sipas nevojave të institucionit.

**Baza ligjore e zbatuar gjatë kryerjes së detyrave nga Sektori i Financës për vitin 2020 është:**

1. udhëzimit Nr.4 datë 25.01.2021, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”.
2. Udhëzimi Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
3. Ligji Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me ligjin 110/2015 datë 15.10.2015.
4. Udhëzimi Nr.7 datë 26.02.2021, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”.
5. Udhëzimi Nr.22 datë 17.11.2016, “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”.
6. Udhëzimi Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
7. Ligji Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me ligjin 110/2015 datë 15.10.2015.